



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Fier, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**Shtojca 13.**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

**07.01.2025**

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE) : “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N, me adresë: FIER Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier.**

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO  JO**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO  JO**

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës: Punë Publike

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, me mjete elektronike

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-28429-11-06-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i Ujësjellësit fshati Kafaraj, Çerven, Adë, Bashkia Fier”**, me fond limit **66,500,000** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind mijë) **lekë pa tvsh**, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Objekti i prokurimit do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet (lëvrohet), me vlerë dhe sasi të plotë brenda afatit të lëvrimin.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **120** (njëqind e njëzetë) **ditë** kalendarike nga data e fillimit të punimeve.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 26.12.2024

<sup>1</sup>Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit [30 Dhjetor 2024] [90]

### KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

❖ **B.O.E: “K.M.K” SHPK/ NIPT L78223801E & “Caushi M” SHPK / NIPT L88419801O**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **50,368,714.2** (pesëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e katërbëdhjetë pikë dy) **lekë pa TVSH.**

❖ **Operatori Ekonomik “LLAZO” shpk**, me **NIPT K24218401K**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **50,198,966** (pesëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**

❖ **Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” shpk me NIPT K61716013M dhe “PE-VLA-KU” shpk dega Kosovë NUI 810794463**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **51,859,737.85** (Pesëdhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**

❖ **B.O.E: “SARDO” SHPK/ NIPT K13120402W & “2Z KONSTRUKSION”/NIPT J63229466K**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **51,500,000** (Pesëdhjetë e një milion e pesëqind mijë) **lekë pa TVSH.**

❖ **Operatori Ekonomik “Shendelli” SHPK/ NIPT K07924803N**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **51,838,326** (Pesëdhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**

❖ **Operatori Ekonomik “XHAËT SHPK” SHPK / NIPT K12512837I**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **58,107,291.98** (Pesëdhjetë e tetë milion e njëqind e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

➤ Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

❖ **B.O.E: “K.M.K” SHPK/ NIPT L78223801E & “Caushi M” SHPK / NIPT L88419801O**, nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:  
Nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik pika a) *Vlerën 50% për një punë të vetme të ngjashme ose pika b) punë e ngjashme deri në një kufi jo më e vogël se dyfishi i vlerës së kontratës.*

<sup>1</sup>Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

B.O.E sipas marrëveshjes midis dy operatorëve OE "K.M.K" ka marrë përsipër të realizojë 83%, Operatori Ekonomik nuk plotëson asnjë prej pikave për punën e ngjashme pasi prej tij është paraqitur vetëm një ujësjellës me Objekt "*Përmirësim furnizimi me ujë në zonën poshtë depove Yzberisht 1,2,Fabrika e qelqit*" ku vlera e punës së ngjashme e operatorëve ekonomik K.M.K & CAUSHI M është **18,565,902.8** duke mos plotësuar zërin për punën e ngjashme e cila duhet të jetë në vlerën 33,250,000.

Janë paraqitur punë të ngjashme rrugë dhe mbrojtje lumore të cilat nuk janë natyrë e ngjashme pune dhe nuk i përkasin **Liçencës NP-7** (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje). Nuk plotëson as pikën b) pasi e vetmja pune e ngjashme ujësjellës është objekti "*Përmirësim furnizimi me ujë në zonën poshtë depove Yzberisht 1,2,Fabrika e qelqit*" ku vlera e punës së ngjashme e operatorëve ekonomik K.M.K & CAUSHI M është 18,565,902.8 punët e tjera janë rrugë dhe mbrojtje lumore të cilat nuk kanë të bëjnë me natyrën e objektit që prokurohet duke mos provuar kapacitetin e punës së ngjashme si: (*Rikonstruksion rr.Behar; Rikonstruksion Nja Katund i Ri Caushi M ; Sistemim rruge Çerçan, Rikonstruksion rruga Rashtan ; Mbrojtje nga Përroi... ; Rikonstruksion gurore vjeter ; Ndërtim Gabionash ; Ndërtim Impjanti etj*)

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit "Deklarata C" Operatori Ekonomik K.M.K nuk plotëson kushtin për Grejder me targa (2 copë). OE nuk plotëson pikën e kërkuar për dokumentacionin e mjeteve teknologjike të targuara pasi nuk ka paraqitur targat për 1 Automjet Teknologjik Grejder.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Deklarat C për mjetet me qera mungojnë të dhënat e kontratës së qerasë për mjetet: I.Eskavator me goma me targa AA428RB dhe AAMT22,mungojnë numrat e kontratës së qerasë për mjetin Autovinc me kapacitet jo më pak se 6 ton deri në 8 ton AB367JC dhe AA213PR. Mungojnë numrat e kontratës së qerasë për mjetin Kamion vetshkarkues me kapacitet jo më pak 10 ton deri në 14ton AA782NY.Mungojnë numrat e kontratës së qerasë për mjetin Autobot uji AA256TE. Mungojnë numrat e kontratës së qerasë për Fadromë me kovë para dhe krahë mbrapa AA312YR. Mungojnë numrat e kontratës së qerasë për Autobitumatrice AA568SM. Mungojnë numrat e kontratës së qerasë për Grejder me goma me targa.

Mjetet Dumper me targa AGMT31 & AIMT14 mungojne numrat e kontratës së qerasë. Rrjedhimisht Deklarata C "*Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate*" konsiderohet e paplotësuar dhe jo në formën komfort ligjit. Tabela ëshë e paplotësuar dhe mungojnë të dhëna të rëndësishme të cilat krijojnë pasaktësi dhe parregullsi. Për mjetet Autovinc me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 ton deri 8 ton me targa AB367JC & AA213PR mungon plotësimi i numrit të shasisë në tabelën e formularit të vetëdeklarimit.

Është detyra e OE të plotësojë të dhënat sipas kërkesave të kualifikimit dhe ti përmbahet formularit të vetëdeklarimit duke ofruar të dhëna të qarta dhe të sakta për zbatimin e ligjit të prokurimit publik.

Mjetet e mësipërme kanë mungesa të formularit të vetëdeklarimit, ndaj kriteri konsiderohet i papërbushur dhe OE skualifikohet.

❖ **Operatori Ekonomik "LLAZO" shpk, me NIPT K24218401K, nuk ka** paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

- Operatori Ekonomik të paraqesë çertifikatë ose deklaratë nga Prodhuesi/ Distributori i Autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matësave të ujit i referohet OIML R49/ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatë Internacionale të Metrologjisë Ligjore. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e aprovimit sipas **MID/ekuivalente me të**, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9875 datë 14.02.2008 i ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr.IOO/2015.

Operatori Ekonomik Llazo shpk **nuk ka paraqitur çertifikatën** sipas kërkesave në kriteret e kualifikimit.

- Në pikën 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X .Operatori Ekonomik ka paraqitur kataloget e Caleffi, Katalog Matësat, Katalogun MIV dhe katalog Modulov 5,8 të papërkthyer dhe të panoterizuar në gjuhën shqipe, për këtë arsye OE skualifikohet.
- Mjeti Minifadromë me goma me targa (mt) AEMT70 me Nr.Leje Qarkullimi ELD00940322 dhe Nr.Shasie CAT0262DCDTB05628 deklaruar nga Operatori Ekonomik “Llazo” shpk me kontratë qiraje e cila fillon në datë 09.09.2024 është deklaruar dhe nga Subjekti Mbështetës “APIS CONSTRUCTION” si subjekt mbështetës i OE “2Z KONSTRUKSION” me të njëjtat të dhëna dhe me kontratë qiraje të lidhur më datë 27.09.2024.

Në këto kushte kontrata e qerasë për subjektin “Llazo” shpk konsiderohet e pavlefshme duke iu referuar faktit se **një automjet mund ti shërbej vetëm një kompanie** dhe duke qenë në kushtet që Subjekti Mbështetës “APIS CONSTRUCTION” me të njëjtin automjet ka lidhur kontratë qiraje pas kontratës së OE “Llazo”shpk, kjo e fundit konsiderohet e pavlefshme.

- Operatori Ekonomik “Llazo” shpk nuk plotëson kriterin mbi **Nënkontraktimin**, bazuar në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (ndryshuar pika 3 e nenit 126 me ligjin nr.16/2024, datë 8.2.2024) ku citohet: *Autoriteti ose enti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Autoriteti kontraktor miraton vetëm nënkontraktorët e mundshëm të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik dhe procesi i miratimit kryhet vetëm në Sistemin e Prokurimit Elektronik.* Operatori Ekonomik “Llazo”shpk nuk ka arritur të paraqesë të gjitha dokumentat dhe sipas afateve të duhura për një nënkontraktor. Kontrata midis sipërmarrësit dhe investitorit është lidhur në datë 19.02.2021, kërkesa nga sipërmarrësi është bërë më datë 16.03.2021 dhe miratimi është në datë 19.03.2021. Duke u bazuar në datat e dokumentave shoqëruese të punëve të ngjashme operatori ekonomik nuk është një nënkontraktor referuar akteve ligjore të ligjit të prokurimit publik për të quajtur punë të ngjashme objektin: Furnizim me ujë i fshatrave Vertop, Bregas, Fushe-Peshtan dhe Vodice, Bashkia Polica. Gjithashtu operatori “Llazo”shpk nuk ka paraqitur kontratën midis “Gener 2” dhe “Llazo” Shpk.

❖ **Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” shpk me NIPT K61716013M dhe “PE-VLA-KU” shpk dega Kosovë NUI 810794463, nuk ka** paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

- Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.10 janë kërkuar (2) mjete Autovinc me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 ton deri në 8 ton, ndërkohë Operatori Ekonomik PE-VLA-KU në formularin e vetëdeklarimit në pikën C: Deklaratë "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate" Operatori Ekonomik ka paraqitur një mjet në pronësi Autovinc me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 ton deri në 8 ton me targa AA467GO, ndërkohë për mjetin tjetër Autovinc në pronësi, nuk janë deklaruar : targat, nr.Lejes së qarkullimit dhe nr.Shasisë por vetëm fatura, duke mos-plotësuar kërkesën pasi për Automjetet me goma të lejuara për qarkullim në Shqipëri, duhet të jenë të pajisur me **Targa, Leje Qarkullimi dhe Nr.Shasie**. OE nuk plotëson kërkesën për 2 Autovinc me kapacitet jo më pak se 6 ton deri në 8 ton.
- Në deklaratën C "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate" mjetet me qira në tabelën Afati i Kontratës së qerasë (data e fillimit dhe mbarimit) operatori ekonomik nuk ka plotësuar tabelen sipas formatit të kërkuar dhe nuk shprehet për afatet e fillimit dhe të mbarimit të kontratave për mjetet me qira të paraqitura prej tij. Shprehet për datën e kontratës në tabelën e numrit të kontratës, por pa caktuar afatin që kanë kontratat, duke krijuar pasaktësi në plotësimin e deklaratës.
- Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.10 janë kërkuar 2 Grejder me targa (mjete teknologjike) të pajisura me targa. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Operatori Ekonomik PE-VLA-KU ka deklaruar Grejder me targa por s'ka deklaruar targat dhe lejet e qarkullimit për mjetet Grejder me targa(mt) duke mos e konsideruar të realizuar kërkesën e kualifikimit.

- Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.10 janë kërkuar 2 minifadromë me targa (Mjetet teknologjike) të pajisura me targa. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Operatori Ekonomik PEVLA-KU ka deklaruar Minifadromë me targa por ska deklaruar targat dhe lejet e qarkullimit për mjetet Minifadrome me targa(mt) duke mos e konsideruar të realizuar kërkesën e kualifikimit.
- Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.10 janë kërkuar 2 *Dumper me targa* (Mjetet teknologjike) të pajisura me targa. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Operatori Ekonomik PE-VLA-KU ka deklaruar Dumper me targa, por ska deklaruar targat dhe lejet e qarkullimit për mjetet Dumper me targa(mt) duke mos e konsideruar të realizuar kërkesën e kualifikimit. Gjithashtu janë 2 *Eskavator me goma me targa (Mjete teknologjike)* Operatori Ekonomik ka deklaruar vetem një Eskavator me goma me targa AJMT65, ndërsa eskavatori tjetër me goma nuk është e pajisur me targa dhe leje qarkullimi duke e konsideruar të përealizuar kërkesën për kualifikim ku kërkohen dy eskavator me goma me targa (mt).
- Në pikën 2.3.6 janë kërkuar respektivisht 2 punonjes të kualifikuar për Punime në rrugë dhe asfalti, në formularin e publikuar nga operatori ky i fundit punonjesi Nexhmedin Baica është deklaruar me certifikata nga *AQScert me nipt L31511026K*. Nga verifikimi në QKB rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshronitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*" Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020.
- Data e deklaratës së punëtorëve shoqëruar me tabelën e kërkuar në pikën 2.3.6, deklarata e tabelës e paraqitur nga O.E PE-VLA-KU ka datën 03.07.2024 dhe i referohet objektit: "*Rrjeti shperndares i furnizimit me uje dhe te KUZ te zones se Fruti Kultures, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz*" me A.K Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.A dhe jo procedurës në fjalë.
- OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.1 mbi përvojën e ngjashme pasi « kontrata e ujësjiellësit për furnizimin me ujë të 10 fshatrave », është jashtë afatit 5-vjecar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pra nuk plotëson gjërmën a).

❖ **B.O.E: "SARDO" SHPK/ NIPT K13120402W & "2Z KONSTRUKSION"/NIPT J63229466K, nuk ka** paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

- Operatori Ekonomik "2Z KONSTRUKSION" është mbështetur në subjektin "APIS CONSTRUCTION" por nuk ka e ka deklaruar këtë në formularin e vetëdeklarimit të seksioni Information mbi Subjektet mbi Kapacitetin e të cilëve do të mbështetet Operatori Ekonomik.
- Subjekti mbështetës APIS CONSTRUCTION ka paraqitur formularin e vjetër të vetëdeklarimit, duke mos-përmbushur kërkesat e Vendimit Nr.10 datë 23.09.2024 "Për miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e Prokurimit E HAPUR (punë)". Në pikën 2.3.5 "*Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën për 3 (tre) muajt e fundit, konkretisht; 1 (një) Inxhinier Ndërtimi - Profili Gjeoteknik ose "ekuivalent"*" B.O.E nuk ka deklaruar një inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik ose « ekuivalent » ndaj kushti konsiderohet i papërmbushur.

- Në marrëveshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga O.E “SARDO” shpk & “2Z KONSTRUKSION” shpk, O.E « 2Z KONSTRUKSION” ka marrë përsipër të kryejë punime asfaltimi, por nuk disponon Punonjës për shtrime rruge dhe asfaltimi të kërkuar në kriteret e kualifikimit. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat per kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Shendelli” SHPK me NIPT **K07924803N**, me adresë: *FIER Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **51,838,326** (*Pesëdhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e gjashtë*) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier” Sh.a, adresa: Lagja “1 Maj”, Rruga “Tasi Dema”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në Dokumentat Standarte të Tenderit, brenda **10 (dhjetë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 58,107,291.98 (*Pesëdhjetë e tetë milion e njëqind e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e tetë*) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO  JO

Nëse Po (Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**MARIO BAKALLI**